



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
**GJYKATA SUPREME E KOSOVËS**  
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

---

Numri i lëndës: 2022:267576  
Datë: 28.04.2023  
Numri i dokumentit: 04232074

**C – IV – 14 – 3208**

**Paditësi :**

H (M) P nga fshati Ll e P i Komunës së Podujevës.

**Kundër**

**E paditura :**

Agjencia Kosovare e Privatizimit me seli në Prishtinë, Rr. “Dritan Hoxha”, nr.55, Prishtinë.

**Për: Palët**

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës (DhPGJSK) për Çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (AKP), me gjykatësin, Agron Hoxhaj, me **dt.28.04.2023**, nxjerr këtë:

**A K T G J Y K I M**

**I. REFUZOHET si e pabazuar** kërkesëpadija e paditësit, H P nga Podujeva e ushtruar kundër Vendimit, PRN046-0459 të dt.26.03.2014 të Autoritetit të Likuidimit të AKP-së për N.SH. FAN “Zahir Pajaziti” me seli në Podujevë (në likuidim), dhe se i njëjti Vendim i Autoritetit të Likuidimit (AL), **VËRTETOHET** si drejtë dhe i bazuar në ligj.

**II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta.**

**Rrethanat Procedurale dhe Faktike :**

Me datën 25 prill 2014, paditësi H P, në DHPGJSK, ka parashtruar ankesë kundër Vendimit PRN046-0459 të dt.26.03.2014, të lëshuar nga Autoriteti i Likuidimit (tutje AL) në kuadër të Agjencisë Kosovare të Privatizimit (AKP) lidhur me N.SH. FAN “Zahir Pajaziti” me seli në Podujevë (në likuidim), e me të cilin i është refuzuar kërkesa për kompensim për 3 (tre) paga të papaguara në shumën e përgjithshme prej 660.00 euro, e të cilën vendim e kundërshton për shkak të shkeljes së ligjit kundër diskriminimit.

Pala paditëse e ka titulluar parashtresën si ”*ankesë*”, mirëpo gjykata të njëjtën e konsideron si padi, në bazë të nenit 35 par.1 të Ligjit për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës,

e cila dispozitë bënë trajtimin e barabartë të parashtrësve me të cilat bëhet “*nisja e procedurave*” pranë Dhomës së Posaçme, pavarësisht faktit se a quhen padi, kërkesë apo ankesë.

Paditësi në pretendimin e mëtejshëm thekson se, ka qenë punëtor para luftës dhe pas luftës i N.SH. FAN “Zahir Pajaziti”, e cila është shitur më 23.03.2006, si dhe ka qenë përfitues i 20 % të shitjes së ndërmarrjes mirëpo tre pagat e fundit kanë mbetur të papaguara, dhe se sindikata e ndërmarrjes në mënyrë të organizuar dhe kolektive brenda afatit ka dorëzuar kërkesën tek AL-ja për kompensim, ku disa punëtorëve – kolegëve nuk iu është refuzuar kërkesa, por iu janë kërkuar dokumente shtesë, ndërsa kërkesa e parashtrësit është refuzuar si e pavlefshme, dhe se për këtë rast konsideron se është diskriminuar nga AL-ja, duke i trajtuar jo barabartë, me kërkesë që gjykata anulon vendimin, PRN046-0459 të dt.26.03.2014 të AL-së, dhe ti njihet e drejta për kompensimin e tre pagave të papaguara në shumë prej 660.00 euro. Ankesës si provë i ka bashkangjitur: Vendimin PRN046-0459 të dt.26.03.2014 të AL-së dhe asnjë provë tjetër.

Me dt.15.03.2023, e paditura, AKP-ja, ka paraqitur mbrojtje ndaj ankesës së paditësit, ka theksuar se Autoriteti i Likuidimit ka kryer një vlerësim të saktë të rrethanave faktike dhe se dispozitat ligjore gjithashtu janë zbatuar saktësisht, se ankesa e parashtrësit – paditësit është e pa pranueshme në përputhje me Ligjin 04/L-034, dhe në këtë mënyrë ka shkëlur nenin 74.2 të Ligjit 06/L-086, dhe se ankesa e parashtrësit është e pabazuar nga neni 36.2.1 i Shtojcës së Ligjit nr.04/L-034 për AKP-në, se AL-ja, ka kryer vlerësimin e drejtë kërkesës dhe ka gjetur atë të pavlefshëm ku citin se “*Elementet në vijim përbëjnë bazë të mirë dhe të mjaftueshme sipas këtij ligji për refuzimin e një Kërkesë apo interesi të pretenduar të kapitalit apo pronësisë: kërkesa apo pretendimi është i pas afatshëm sipas kufizimeve kohore të aplikueshme*”, duke theksuar se kërkesa duhet të jetë paraqitur në ndonjë gjykatë apo autoritet tjetër kompetent brenda tre vjetëve nga momenti kur NSH-ja, nuk ka përmbushur ndaj parashtrësit obligimet e saj që rrjedhin nga marrëdhënia e punës që është tre vjet nga koha kur parashtrësi kishte fituar të drejtën për të parashtruar kërkesë për të kërkuar kompensim për paga të papaguara, andaj vendimi nuk bie në kundërshtim me asnjë dispozitë të Ligjit nr.04/L-034 për AKP-në, dhe i paraqet gjykatës që të refuzoj ankesën e paditësit si të papranueshme dhe të pa bazuar dhe ta vërtetoj Vendimin e Autoritetit të Likuidimit (AL).

Me Urdhrin e saj, C – IV. – 14 - 3208 të dt.15.03.2023, gjykata paditësit i ka dorëzuar mbrojtjen të paditurës, dhe se i njëjti, ka paraqitur përgjigje ndaj mbrojtjes së të paditurës, e në të cilën, në mes tjerash ka theksuar se është e drejtë e tij në kërkesën për pagat e pa paguara dhe rishikimin e Vendimit PRN046 - 0459 të dt.26.03.2014, se i kundërshton pretendimet e të paditurës se ankesa e tij është e pa pranueshme dhe i ka propozuar gjykatës që pas shqyrtimit të përgjigjes në mbrojtje të aprovon kërkesën e tij si të bazuar dhe t’ a ri shikon edhe një herë Vendimin e Autoritetit të Likuidimit, N.SH. FAN “Zahir Pajaziti” (në likuidim), dhe t’ i kompensohen pagat e pa paguara si dhe të refuzohet mbrojtja e të paditurës.

Me Urdhrin e saj, C – IV. – 14 - 3208 të dt.06.04.2023, gjykata, të paditurës, ia ka dorëzuar Përgjigjen e paditësit të bërë në mbrojtjen e të paditurës dhe se e paditura, me dt.24.04.2023, ka paraqitur, Kundërpërgjigje e në të cilin ka theksuar se pala paditëse në bazë të nenit 7 të LPK-së, ka barrën e provave se paditësi, nuk ka paraqitur ndonjë argument të ri mbi të cilin do të mbështeste pretendimet e tij, se kërkesa e paditësit, në bazë të nenit 36.2 të Shtojcës së Ligjit, Nr,04/L – 034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, mbetet e pa kompletuar, dhe e pas afatshme sipas kufizimeve kohore të aplikueshme, se kërkesa e paditësit, është e parashtruar sipas nenit 608 të Ligjit të Punës së Bashkuar, i aplikueshëm sipas nenit 1 Rregullores së UNMIK-ut, nr.1999/24 pasi që ajo parashihet parashkrimin e kërkesës pra për pagesën e pagesës ose rrogës apo të ndonjë kërkesë tjetër nga marrëdhënia e punës në afatin prej 3 viteve dhe i ka

propozuar gjykatës që të refuzoj si të pa bazuar parashtrësën si të pa pabazuar dhe/apo të pa pranueshme dhe të vërtetohet (lë në fuqi) Vendimin e Autoritetit të Likuidimit.

### **Arsyetimi ligjor:**

Në bazë të nenit 2 par.4 dhe nenit 77 par.1 pika 1.1 të Ligjit Nr.06-L-086 të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për Çështjet që Lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejme Ligji për Dhomën e Posaçme), gjykata zbaton dispozitat procedurale të këtij ligji.

Procedura gjyqësore pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për Çështjet në Lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në vazhdim: Dhoma e Posaçme), është e rregulluar Ligjin nr.06/L-086 për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për Çështjet në Lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, si ligj i veçantë.

Në bazë të nenit 76 paragrafi 3 të Ligjit Nr.06/L-086 të DHPGJSK-së, lidhur me nenin 399 të Ligjit mbi Procedurën Kontestimore (LPK), gjykata përcakton se faktet relevante të rastit janë të pakontestueshme dhe nxjerrë këtë aktgjykim pa caktuar seancë dëgjimore.

Pas shqyrtimit të provave të lëndës parashtrimeve dhe pretendimeve të palëve në procedurë gjykata ka ardhur në përfundimin se kërkesëpadia e paditësit, është e pabazuar.

Në bazë të nenit 31 par.1 i Ligjit Nr. 06-L-086 për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës, përcaktohet se: *''Palët, në parashtrësat e tyre me shkrim, duhet të paraqesin një pasqyrë gjithëpërfshirëse të fakteve që ato palë i dinë, apo me arsye besojnë të jenë relevante apo materiale për kërkesën, lëndën, procedurën apo rastin përkatës''* kurse në nenin 36 par.2 pika 1 të Shtojcës së Ligjit nr. 04/L-034 për AKP-në, parashihet se *''... elementet në vijim përbëjnë bazë të mirë dhe të mjaftueshme sipas këtij ligji për refuzimin e një Kërkese apo interesi të pretenduar të kapitalit apo pronësisë''*.

Po ashtu në zbatim të dispozitës së nenit 40 par.1 pika 6.1 të Shtojcës të Ligjit për AKP-në, aty citohet se: *''Kërkesat për pagat e punonjësve të cilat nuk janë paguar deri në datën e vendimit nga Gjykata apo Agjencia për fillimin e procedurave të likuidimit, të kufizuar në tri paga mujore bruto për person''* dhe se këto kërkesa dhe interesa të kreditorëve do të përmbushen në pajtim me kategoritë 1.1 – 1.8 nga neni 40 i Ligjit nr.04/L-034 për AKP-në kurse edhe në nenin 42 pika 2 të Ligjit për Dhomën e Posaçme, parashihet se: *''Pala që pretendon një fakt apo ngjarje ka barrën e dëshmisë për të dëshmuar vërtetësinë e pretendimit të tillë, duke paraqitur parashtrësat apo duke paraqitur provat materiale (të dokumentuara, fizike dhe/ose dëshmuese) ndërsa pika 3 parasheh se: ''Pala që pretendon një fakt apo ngjarje ka mundësinë e arsyeshme për të paraqitur apo dorëzuar provat materiale për të mbështetur një pretendim të tillë, nëse pala e tillë dështon që të paraqesë apo dorëzojë provat e tilla, atëherë vlerësohet se pala nuk ka ofruar barrën e dëshmisë lidhur me pretendimin e tillë''* ndërsa sipas nenit 7 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), palët kanë për detyrë t'i paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen faktet e tilla. Me fjalë të tjera, kushdo që thotë diçka duhet ta dëshmojë atë (ei incumbit probatio qui dicit) pasi që ankuesi - paditësi fillimisht nuk kishte parashtruar prova relevante në procedurën e likuidimit pranë AL-së, për të mbështetur besueshmërinë e kërkesës së tij, andaj në arsyetimet e paraqitura më lartë gjykata konstaton se AL-ja me rastin e refuzimit të kërkesës së parashtrueses tek AL-ja, drejtë ka vepruar, dhe se ligji është zbatuar drejtë në këtë çështje juridike.

Në nenin 74 të Ligjit Nr. 06-L-086 për Dhomën e Posaçme, që flitet për shqyrtimin e vendimeve të Autoritetit për likuidim, aty thuhet se :’’ *Procedura para Dhomës së Posaçme për kundërshtimin e vendimit të një Autoriteti të Likuidimit që është duke kryer likuidimin e një ndërmarrje ose aseti sipas Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit do të rregullohet në bazë të këtij neni. Çdo kreditor i Ndërmarrjes i cili ka dorëzuar me kohë kërkesën në Agjenci dhe i cili cenohet nga një vendimi i Autoritetit të Likuidimit mund ta kundërshtojë vendimin e tillë, duke parashtruar një ankesë në Dhomën e Posaçme kundër Agjencisë brenda tri dhjetë (30) ditëve pas pranimit të vendimit. Çdo ankesë e këtillë duhet të bazohet në pretendimin se procesi i likuidimit nuk është kryer në pajtim me Ligjin për Agjencinë Kosovare të Privatizimit ... ’’.* Ndërsa në nenin 76 paragrafi 3 i të Gjykatës Supreme të Kosovës , parashihet se: “*Në interpretimin dhe zbatimin e këtij ligji, kudo që është e nevojshme për të zgjidhur një çështje procedurale që nuk trajtohet mjaftueshëm me këtë ligj, Dhoma e Posaçme do të zbatojë mutatis mutandis dispozita përkatëse të Ligjit mbi Procedurën Kontestimore*” derisa sipas nenit 7 par.1 i Ligjit për Procedurën Kontestimore, parashihet se : “*Palët kanë për detyrë të paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen faktet e tilla*”.

Gjykata ka shqyrtuar pretendimet dhe provat të cilat i kanë ofruar palët ndërgjyqëse dhe ka konstatuar se N.SH. FAN “Zahir Pajaziti” (në likuidim), me seli në Podujevë, ka hyrë në procedurë të likuidimit me dt.24.03.2006 derisa është vendosur në likuidim me dt.02.09.2013 ndërsa parashtruesi ka parashtruar kërkesën tek AL-ja me dt.01.10.2013, që është brenda afatit për parashtrimin e kërkesave në procedurë të likuidimit tek AL-ja ndërsa ankesën pranë DhPGJSK-së, e ka bërë me dt.25.04.2014, pra brenda afatit të paraparë ligjor prej 30 ditëve pas ditës së pranimit të Vendimit të Autoritetit të Likuidimit (AL), PRN046-0459 të dt.26.03.2014.

Gjykata gjen se nuk është kontestuese se në mes të palëve ndërgjyqëse qëndron raporti juridik i pretendimit të paraqitur lidhur me kërkesën për kompensimin e tre pagave të fundit të papaguara për periudhë kohore të pacaktuar prej 660.00 euro, lidhur me N.SH. FAN “Zahir Pajaziti” (në likuidim) e cila kërkesë është refuzuar si e pavlefshme me Vendimin e AL-së, PRN046-0459 të dt.26.03.2014 të AL-së, në përputhje me nenin 36.2.1 të Shtojcës të ligjit nr.034/L-034 por kontestuese mbetet për palën paditëse vendimi të cilin e kundërshton për shkak të shkeljes së ligjit kundër diskriminimit duke i trajtuar jo barabartë punëtorët e ndërmarrjes si dhe çështja se a ka parashkrim të kërkesës së paditësit.

Tutje kontestuese pra mbetet baza juridike e kërkesës të cilën e paditura, e ka konsideruar si të parashkruar e të cekur në Vendimin e AL-së, PRN046-0459 të dt.26.03.2014 dhe së këto pretendime të të paditurës, AKP-së, dhe qëndrimin e saj juridik të shprehur në këtë Vendim të AL-së, gjykata e merr si të drejtë pra kur AL-ja, e ka bërë refuzimin e kërkesës së parashtruesit këtu paditësit si të pa vlefshme pasi që AL-ja, drejtë ka zbatuar dispozitën materiale nga neni 36.2.1 të Shtojcës së Ligjit nr.04/L-034 për AKP-në lidhur me nenin 608 të Ligjit të Punës së Bashkuar (GZ nr.53 viti 1976), dhe se paditësi, para bërjes së kërkesës te AL-ja, nuk ka prova se i është drejtuar ndonjë organi tjetër apo gjykatës për realizimin e kërkesës së tij për pagat e pa paguara e meqë në rastin konkret, kemi të bëjmë me parashkrimin e kërkesës sipas vendimit të AL-së, andaj kërkesëpadinë e paditësit, duhet refuzuar si të pabazuar dhe se të njëjtin vendim gjykata duhet t’ a vërteton si të drejtë dhe të ligjshëm derisa çështje tjetër për gjykatën mbetet pretendimi i paditësit për diskriminimin e mundshëm pasi që paditësi, nuk e ka precizuar periudhën kohore për të cilën e ka kërkuar kompensimin e 3 (tri) pagave të pa paguara.

Në Vendimin e AL-së, PRN046-0459 të dt.26.03.2014, i kundërshtuar nga paditësi, gjykata gjen, kërkesa për kompensim, ka të bëjë me 3 (tri) paga të fundit të papaguara (3 x 220.00 euro), në

shumë të përgjithshme 660.00 euro, për kohë të pacaktuar, e cila është refuzuar nga AL-ja, në mungesë të dëshmive për të mbështetur ekzistencën e një obligimi të tillë, për të cilën kërkesë pala paditëse edhe me rastin e paraqitjes së ankesës në këtë gjykatë nuk ka ofruar ndonjë dëshmi që do të vërtetonte se N.SH. FAN “Zahir Pajaziti” (në likuidim), nuk ka kryer obligimet për paga ndaj ankuesit, gjegjësisht ankesa i referohet se punëtorët nuk janë trajtuar barabartë nga AL-ja, për të cilën kjo gjykatë vije në përfundim se çdo parashtrues eventuale i kërkesave trajtohet sipas fakteve dhe provave të cilat u paraqiten autoriteteve kompetente, siç është tani me rastin e paraqitjes së padis/ankesës në këtë gjykatë.

Është me rëndësi të theksohet fakti se gjykata edhe në këtë çështje juridike vendos mbi bazën e fakteve dhe provave që kanë parashtruar palët, për të cilën pala ankuese nuk ka ofruar asnjë provë apo dëshmi që do të vërtetonte se pala ankuese nuk ka realizuar pagat për një periudhë të caktuar kohore, andaj nuk mund të merret si e drejtë kërkesa e parashtruesit, nëse të njëjtën kërkesë nuk e ka bërë të besueshme përmes ndonjë fakti apo prove që gjykata të aprovonte kërkesën e tillë. Baza e kërkesës dhe numri i pagave të kërkuara në këtë procedurë duhet të mbështetet plotësisht me provat përkatëse të besueshme. Pra, në këtë kuptim, ankuesi ka dështuar që të parashtrojë prova në mbështetje të kërkesës së tij të përcaktuara me nenin 7 lidhur me nenin 319 të LPK-së. Gjykata gjen se në mungesë të dëshmive, pretendimet e paditësit lidhur me të drejtën e tij në kompensim për paga të papaguara, nuk janë të mbështetura me provat e nevojshme materiale, prandaj si të tilla janë refuzuar si të pabazuara.

Gjykata konstaton se e paditura me rastin e refuzimit të kërkesës së parashtruesit drejtë ka vendosur. Gjykata ka shqyrtuar edhe pretendimet e tjera të palëve ndërgjyqëse, por të njëjtat ishin pa efekt në vendosjes ndryshe të kësaj çështje juridike nga ajo siç është vendosur në këtë aktgjykim.

Prandaj nga ajo që u tha më lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi e në bazë të nenit 4 par.9, nenit 9, 36 par.1 dhe 3, 74 par. 2 dhe nenit 77 par.1 pika 1 të Ligjit nr. 06/L - 086 të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës (DhPGJSK).

### **Shpenzimet Gjyqësore**

Në bazë të nenin 62 par. 5 të Ligjit nr. 06/L-086 të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës, secila palë i bart shpenzimet e veta procedurale.

## **DHOMA E POSAÇME E GJYKATËS SUPREME TË KOSOVËS** **2022:267576, 28.04.2023**

**Gjykatësi,**  
**Agron Hoxhaj**

### **KËSHILLË JURIDIKE :**

Kundër këtij aktvendimi mund të parashtrohet ankesë me shkrim në Kolegjin e Apelit të Dhomës së Posaçme dhe atë brenda **15 (pesë mbëdhjetë) ditëve** pas ditës së pranimit të këtij aktvendimi. Ankesa duhet të dorëzohet në bazë të nenit 9 par.6 të Ligjit për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës.